



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 100, datë 26.6.2024

PËR

**PROCEDURAT DHE ORGANIZMIN E PUNËS SË KOMITETIT
SHTETËROR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të kreut III, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator,

URDHËROJ:

1. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian (në vijim Komiteti Shtetëror) të mblidhet me kërkesë të kryetarit, ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator ose me kërkesë të shumicës së anëtarëve të tjerë.
2. Mbledhja e Komitetit Shtetëror të drejtohet nga kryetari dhe, në mungesë apo me porosi, mbledhja të drejtohet nga ministri i Shtetit dhe Kryenegociator.
3. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së Komitetit Shtetëror të dërgohet në mënyrë elektronike, të paktën 3 (tri) ditë përpara ditës së përcaktuar për mbajtjen e mbledhjes. Njoftimi të shoqërohet me rendin e ditës së propozuar për mbledhjen, dokumentacionin për diskutim dhe informacionin për vendin, datën dhe orarin e mbajtjes së mbledhjes.
4. Përjashtimisht dhe në raste urgjente, kryetari i Komitetit Shtetëror dhe/ose i autorizuari prej tij nga anëtarët mund të thërrasë mbledhjen, jo më vonë se 1 (një) ditë përpara ditës së përcaktuar për mbajtjen e mbledhjes.

5. Rendi i ditës i propozuar nga kryetari, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij urdhri, të miratohet në fillim të mbledhjes.
6. Çdo kërkesë për trajtimin e çështjeve jashtë rendit të ditës të diskutohet nën rubrikën “çështje të tjera”, përpara përfundimit të mbledhjes.
7. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator i propozon kryetarit çështjet për rendin e ditës, në emër të grupit negociator, sipas parashikimeve të shkronjës “a”, të pikës 3, të kreut V, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, si dhe çështje të tjera për negociatat dhe procesin e integritimit evropian.
8. Komiteti Shtetëror të orientojë ministrin, që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore për kapitullin/grupkapitullin përkatës të *acquis*-it, si dhe grupin negociator për propozimin për piketat hapëse, të ndërmjetme dhe mbyllëse, si dhe qëndrimin negociues për grupkapitujt negociues, përpara miratimit të tyre.
9. Sekretariati për integrimin evropian të ngarkohet si sekretariat teknik për mbështetjen administrative të zhvillimit të veprimtarisë së Komitetit Shtetëror dhe ndjekjen e rekomandimeve përmes strukturës negociuese.
10. Sekretariati teknik të mbajë procesverbal, i cili nënshkruhet nga sekretari i sekretariatit teknik.
1. Ngarkohen Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Sekretariati i Integritimit Evropian për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA